



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:074533  
Datë: 15.03.2024  
Numri i dokumentit: 05457934

**P.nr.46/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Amar Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurve B.T., dhe K.Sh., që të dy nga Prishtina, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i përgjithshëm, PP/II.nr.1394-5/17 të datës 28.01.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 14.04.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit-Ramadan Koro, dëmtuarve dhe të pandehurve, me datë 14.03.2024, mori dhe me datë 15.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1394-5/17 të datës 28.01.2018, **PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurve B.T., dhe K.Sh., që të dy nga Prishtina, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**-Për shkak se Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar është tërhequr nga aktakuza.**

Të dëmtuarit T.K., dhe N.K., që të dy nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Personit të tretë F.I., nga Prishtina pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i **KTHEHET** automjeti i tipit ....., me nr. të shasisë ....., me targa ..... pronë e Fidaim Islami, si dhe certifikata e regjistrimit nr. ...., ashtu që **shfuqizohet** urdhëresa për sekuestrim të përkohshëm Ppr.nr.273/17 e datës 15.09.2017.

**URDHËROHET** Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar në Prishtinë, që ti heq të gjitha ndalesat të cilat janë urdhëruar sipas urdhrit të lartpërmendur ndaj automjetit, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1394-5/17 të datës 28.01.2018, kundër të akuzuarve B.T., dhe K.Sh., për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe secili veç veç për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.16/2021 të datës 20.01.2022, ka veçuar procedurën ndaj të pandehurve të lartpërmendur, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 186 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lëndën e ka proceduar në Departamentin e Përgjithshëm, të kësaj gjykate. Ndërsa, me aktgjykimin PKR.nr.16/2021 të datës 24.01.2022 e ka shpallur fajtor të pandehurin K.Sh., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe të pandehurin B.T., me aktgjykimin PKR:nr.9/2022, të datës 07.11.2022, e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i çështjes, pas pranimit të kësaj lënde me datë 16.02.2024, dhe verifikimit të lëndës ka caktuar shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale.

Në seancën publike të shqyrtimit fillestar, prokurori i shtetit, pas leximit të aktakuzës ka deklaruar se, koha e kryerjes së veprës penale në këtë rast duhet të jetë 26.05.2017, e jo siç është në aktakuzë 26.05.2018, pasi që pas shikimit të gjitha shkresave të lëndës përfshirë kallëzimin penale, provat të cilat janë bashkangjitur kallëzimit penal, aktvendimit mbi fillimin e hetimeve, aktvendimit mbi zgjerimin e hetimeve, rrjedh se koha e shkruar në aktakuzë data 26.05.2018, është bërë gabimisht, pra është një gabim teknik sepse koha e saktë duhet të jetë data 26.05.2017, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Prokuroi i shtetit pas precizimit të kohës së kryerjes së veprës penale, dhe deklarimeve të palëve, ka deklaruar se meqenëse nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar 6 vite, dhe për veprën penale ngacmimi nga neni 186 par. 1 të KPRK nr.04/L-082, i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 vite dhe në bazë të nenit 106 par. 1 nën par. 1.5 lidhur me nenin 107 par. 6 të KPRK-së, nuk mund të vazhdohet ndjekja penale për shkak të dyfishimit të afatit të parashkrimit andaj mbi këtë bazë vepra penale ngacmimit del se është parashkruar. Dhe mbi këtë bazë prokurori i shtetit në bazë të nenit 51 të KPP-së nr. 08/L-032, është tërhequr nga ndjekja penale për të akuzuarit B.T., dhe K.Sh.,.

Pasi që në shqyrtimin fillestar Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarve B.T., dhe K.Sh., gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 287 parag.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori konform nenit 462 par.3 të KPPK-së.

Gjykata duke u bazuar në nenin 113 të KPP-së, ka vendosur që personit të tretë Fidaim Islami ti kthehet automjeti i cili ishte ndaluar sipas urdhëresës për sekuestrim të përkohshëm Ppr.nr.273/17 të datës 15.09.2017, të përshkuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ashtu që ka vendosur që të shfuqizojë urdhrin e lartpërmendur dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi

ka urdhëruar APSK-ën në Prishtinë, që ti heq të gjitha ndalesat të cilat janë urdhëruar për këtë automjet, për shkak se procedura në këtë çështje penale është pushuar për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza dhe se gjykata nuk e ka vërtetuar faktin se i njëjti ka qenë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale apo të është përdorur me kryerjen e veprës penale, prandaj është bërë kthimi për shkak se nuk ka pasur bazë për konfiskimin e tij.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 453 parag.1 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
***Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal***  
**P.nr.46/2022 më datë 15.03.2024**

**Zyrtari Ligjor**  
**Amar Hoxha**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Arlind Sharani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 5 (pesë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.